



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurorja e Specializuar k. Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe
Haxhi Shalës**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 17 korrik 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidencial dhe *Ex Parte*

Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Sabit Januzit për Seancë

Zyrës Administrative

Fidelma Donlon

Mbrojtjes së Sabit Januzit

Xhonatan Elistan Ris

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të neneve 34(7) dhe 39(1) të Ligjit nr. 05/L 053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 9(5)(b) dhe 23(6) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 2 korrik 2024, Mbrojtja e Sabit Januzit ("Mbrojtja e Januzit" dhe "z. Januzi") dorëzoi kërkesë urgjente ku kërkonte që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të thërriste një seancë në bazë të rregullës 96(1)(c) të Rregullores për të diskutuar disa pika në lidhje me kërkesën e mbrojtjes për ndihmë juridike para Dhomave të Specializuara ("DHS") ("Kërkesa").²
2. Më 4 korrik 2024, në bazë të urdhrit të Gjykatësës së Procedurës Paraprake ("Urdhri"),³ Administratorja dorëzoi parashtrime lidhur me Kërkesën ("Parashtrimet").⁴
3. Më 8 korrik 2024, në bazë të Urdhrit, Mbrojtja e Januzit iu kundërpërgjigj Parashtrimeve ("Kundërpërgjigja").⁵

II. PARASHTRIMET

4. Në Kërkesë, Mbrojtja e Januzit pretendon se kontrata katërvjeçare për ndihmë juridike që i ofron Zyra e Mbrojtjes parasheh një tavan financimi në formën e "vlerës

¹ KSC-BC-2023-10, F00327, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësës Paraprake*, 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00356, Mbrojtja e Januzit, *Kërkesë Urgjente e Januzit për Seancë*, 2 korrik 2024, konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2023-10, F00359, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Urdhër për Parashtrime nga Administratorja dhe për Ndryshimin e Afateve për t'iu Përgjigjur Kërkesës F00356*, 3 korrik 2024, konfidencial dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00371, Administratorja, *Parashtrime të Administratores në bazë të Urdhrit F00359*, 4 korrik 2024, konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-2, konfidenciale dhe *ex parte*.

⁵ KSC-BC-2023-10, F00376, Mbrojtja e Januzit, *Kundërpërgjigje lidhur me Kërkesën Urgjente të Mbrojtjes së Januzit për Seancë*, 8 korrik 2024, me Shtojcat 1-3, konfidenciale dhe *ex parte*.

së gjithsejtë të kontratës”, që nuk gjendet në Udhëzuesin e Punës të Zyrës Administrative – Rregullorja e Ndhmës Juridike (“Rregullorja e Ndhmës Juridike”).⁶ Mbrojtja e Januzit ankohet se Zyra e Mbrojtjes refuzon të shpjegojë përlllogaritjen e tavanit në fjalë.⁷ Mbrojtja e Januzit më tej parashtron se Zyra e Mbrojtjes kërkon ulje të honorarit për ndihmë juridike për të pasqyruar vendimin lidhur me kërkesën që është bërë në emër të z. Januzi për financim sipas Ligjit nr. 05/L-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara.⁸ Mbrojtja e Januzit shprehet se, sidoqoftë Zyra e Mbrojtjes e pranon se nuk ka kopje të vendimit në fjalë nga Ministria e Drejtësisë së Kosovës (“Ministria e Drejtësisë”) dhe se kjo e fundit nuk ka pranuar t’i japë një kopje të këtij vendimi z. Januzi.⁹ Mbrojtja e Januzit pretendon se, pa iu dhënë zgjidhje aspekteve të mësipërme, nuk mund të nënshkruajë kontratën për ndihmë juridike që i ofron Zyra e Mbrojtjes.¹⁰

5. Në Parashtrimet e saj, Administratorja pretendon se pikat e ngritura nga Mbrojtja e Januzit janë zgjidhur plotësisht gjatë komunikimeve të shumta me Mbrojtjen e Januzit si dhe në Parashtrimet e saj.¹¹ Administratorja parashtron se hapi i fundit që ka mbetur për realizimin e caktimit me kusht të Xhonatan Ris (“z. Ris”) si mbrojtës të z. Januzi si dhe për ofrimin e ndihmës juridike për z. Januzi është dorëzimi i dokumenteve të nevojshme nga Mbrojtja e z. Januzi, për procesin e nënshkrimit të kontratës.¹²

⁶ KSC-BD-024-Rev1, Administratorja, Udhëzues i Punës së Zyrës Administrative – Rregullorja për Ndhmë Juridike ([Registry Practice Direction – Legal Aid Regulations](#)), 22 shkurt 2024, publik.

⁷ Kërkesa, para. 2.

⁸ Kosovë, Ministria e Drejtësisë, Ligji nr. 05/L-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara ([Law No. 05/L-054 on Legal Protection and Financial Support for Potential Accused Persons in Trials before the Specialist Chambers](#)), 31 gusht 2015.

⁹ Kërkesa, para. 3.

¹⁰ Kërkesa, para. 4.

¹¹ Parashtrimet, para. 34. *Shih gjithashtu* Parashtrimet para. 3-33.

¹² Parashtrimet, para. 34.

6. Në Kundërpërgjigje, Mbrojtja e Januzit, në thelb, përsërit kërkesën e vet për seancë dhe paraqet një listë me shtatë pika për diskutim, përfshirë lidhur me një urdhër të Ministrisë së Drejtësisë.¹³

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Në bazë të nenit 34(7) të Ligjit dhe rregullës 23(6) të Rregullores, Zyra Administrative përfshin në kuadër të saj Zyrën e Mbrojtjes, e cila administron, në emër të Administratores, një sistem të ndihmës juridike për përfaqësimin e të akuzuarve të varfër ose pjesërisht të varfër para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

8. Në bazë të rregullës 9(5)(b) të Rregullores, nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, paneli mund të njohë si të vlefshëm çfarëdo veprimi të ndërmarrë pas përfundimit të afatit përkatës.

IV. DISKUTIM

A. ASPEKTI PARAPRAK

9. Administratorja kërkon që Gjykatësja e Procedurës Paraprake të pranojë Parashtrimet, të cilat i dorëzoi pas afatit të përcaktuar në Urdhër, d.m.th jo më vonë se 4 korriku 2024, në orën 16:00, si të vlefshme në bazë të rregullës 9(5)(b) të Rregullores.¹⁴ Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban parasysh shpjegimin e Administratores se nuk pati mundësi të dorëzonte Parashtrimet në kohë për shkak të një urgjence personale të papritur.¹⁵ Gjykatësja e Procedurës Paraprake po ashtu merr në konsideratë vonesën e vogël, pasi Administratorja i dorëzoi Parashtrimet pak orë pas përfundimit të afatit, konkretisht në orën 20:09. Gjykatësja e Procedurës Paraprake është bindur më tej se vonesa në fjalë nuk i shkaktoi asnjë dëm Mbrojtjes së Januzit. Si

¹³ *Shih* Kundërpërgjigjen, para. 3-39.

¹⁴ Parashtrimet, para. 36. *Shih* Urdhrin, para. 7(a).

¹⁵ Parashtrimet, para. 36.

rezultat, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se Administratorja ka paraqitur arsye të vlefshme dhe, për rrjedhojë, i pranon Parashtrimet të dorëzuara si të vlefshme në bazë të rregullës 9(5)(b) të Rregullores.

B. THEMELËSIA

10. Fillimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se administrimi i sistemit të ndihmës juridike është në sferën e përgjegjësive të Administratores në bazë të nenit 34(7) të Ligjit dhe rregullës 23(6) të Rregullores. Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban parasysh se Rregullorja e Ndhmës Juridike përcakton, ndër të tjera, kriteret dhe procedurën për caktimin e mbrojtësit si dhe të administrimit të sistemit të ndihmës juridike për personat e varfër dhe pjesërisht të varfër para DHS-së.¹⁶ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren më tej se ndërhyrja e panelit në këtë kontekst kërkohet vetëm në rrethana të veçanta, në bazë të rregulloreve 11(4) dhe 18(7) të Rregullores së Ndhmës Juridike.¹⁷

11. Më tej, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, në Kërkesë, Mbrojtja e Januzit nuk i kërkon Gjykatësës së Procedurës Paraprake të rishikojë vendimin lidhur me caktimin me kusht dhe ndihmën juridike, por kërkon seancë për të marrë informacion lidhur me aspektet e paraqitura në Kërkesën e vet, të shtjelluara më tej në Kundërpërgjigjen e vet.

12. Në këtë drejtim, Gjykatësja e Procedurës Paraprake merr parasysh korrespondencën e shumtë mes z. Ris dhe Zyrës Administrative nga shkurti 2024 e deri më tani.¹⁸ Sipas materialit para Gjykatësës së Procedurës Paraprake,

¹⁶ *Shih* Rregulloren 1 të Rregullores së Ndhmës Juridike.

¹⁷ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, sipas Rregulloreve 11(3), 18(1)-(2), (6) dhe (7) të Rregullores së Ndhmës Juridike, pasi caktohet dhe kontraktohet me kusht mbrojtësi në bazë të Rregulloreve 11(1) dhe (3) dhe 22 të Rregullores së Ndhmës Juridike, dhe Pjesës 14(3) të Udhëzuesit të Punës së Administratores – Direktiva për Mbrojtësit, në qoftë se mbrojtësi i caktuar vlerëson se tarifa e ndihmës juridike është e pamjaftueshme, mbrojtësi i caktuar (me kusht) mund t'i kërkojë Administratores të ndryshojë tarifën e ndihmës juridike dhe, më pas, nëse gjykohet e nevojshme, kërkon rishikim nga gjykatësit e panelit përgjegjës.

¹⁸ *Shih* Shtojcën 2 të Parashtrimeve.

Administratorja lëshoi Vendimin për Caktimin me Kusht të z. Ris si Mbrojtës së Z. Januzi dhe Honorarin për Ndhmë Juridike, më 24 qershor 2024 (KSC/REG/IOR/7070) ("Vendimi i 24 Qershorit 2024").¹⁹ Në paragrafin 55 të Vendimit të 24 qershorit 2024, Mbrojtësit Ris i kërkohet të nënshkruajë kontratën në mënyrë që të lëshohet shkresa për caktimin me kusht. Po ashtu, në paragrafin 56 të Vendimit të 24 qershorit 2024, Mbrojtësit Ris i kërkohet të dorëzojë planin e punës,²⁰ në vijim të së cilit do të përcaktohet kompleksiteti i çështjes gjyqësore.²¹ Sipas materialit të disponueshëm, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se procesi për nënshkrimin e kontratës për caktimin me kusht të z. Ris si mbrojtës të z. Januzi nuk ka përfunduar ende.²²

13. Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se disa prej pikave që Mbrojtja e Januzit kërkon të diskutojë në seancë²³ ose nuk kanë lidhje me caktimin me kusht të mbrojtësit Ris dhe pagesën e ndihmës juridike,²⁴ ose janë shpjeguar në Rregulloren e Ndhmës Juridike.²⁵ Pikat e tjera që propozon të diskutojë Mbrojtja e Januzit kanë shumë pak relevancë për caktimin me kusht dhe honorarin provizor për ndihmë juridike, të përcaktuar në Vendimin e 24 Qershorit 2024, gjegjësisht funksionimi i një Organi Përfaqësues të Pavarur²⁶ dhe pikëpamjet e SHM-GJTN (Shoqata e Mbrojtësve që Punojnë para Gjykatave dhe Tribunalëve Ndërkombëtarë) ADC-ICT lidhur me Rregulloren e Ndhmës Juridike të DHS-së, të rishikuar.²⁷ Së fundi, sa i përket propozimit të Mbrojtjes së Januzit për të diskutuar urdhrin e mundshëm drejtuar

¹⁹ *Shih* Shtojcën 2 të Parashtrimeve, Pika 37, f. 163.

²⁰ *Shih* Rregulloren 13(2) të Rregullores së Ndhmës Juridike.

²¹ *Shih* Rregulloren 16(1) të Rregullores së Ndhmës Juridike.

²² *Shih* Parashtrimet, para. 34; Shtojcën 2 të Parashtrimeve, Pika 39, f. 179.

²³ Kundërpërgjigjja, para. 39(a)-(d).

²⁴ Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se ndihma juridike që gëzon z. Januzi trajtohet në Rregulloren e Ndhmës Juridike dhe Vendimin e 24 Qershorit 2024 në lidhje me caktimin me kusht dhe honorarin për ndihmë juridike të përkohshëm. *Shih* Parashtrimet, para. 20.

²⁵ *Shih* Rregulloren 16 të Rregullores së Ndhmës Juridike.

²⁶ *Shih* Njoftimin për shtyp "Mbrojtësit e Specializuar themelojnë Organin Përfaqësues të Pavarur", 9 dhjetor 2019, gjendet në: <https://www.scp-ks.org/en/specialist-counsel-establish-independent-representative-body> (qasja më e fundit më 17 korrik 2024).

²⁷ Kundërpërgjigjja, para. 39(e)-(f).

ministrisë së Kosovës për t'i dhënë Mbrojtjes së Januzit një kopje të vendimit për të financuar mbrojtësin Ris me 1.000 euro në muaj për të përfaqësuar z. Januzi,²⁸ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtësi Ris i ka konfirmuar Zyrës Administrative se është informuar, përmes postës elektronike, drejtpërdrejt nga Ministria e Drejtësisë lidhur me vendimin për ta financuar.²⁹ Meqenëse, Rregullorja e Ndhmës Juridike nuk përmban ndonjë formular të caktuar për informim lidhur me financimin nga palë të treta (në këtë rast, vendimin e Ministrisë së Drejtësisë), Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerëson se nuk është e nevojshme të mbahet seancë për të diskutuar këtë pikë.

14. Për rrjedhojë, sipas Gjykatësës së Procedurës Paraprake, caktimi i seancës, siç kërkohet nga Mbrojtja e Januzit, nuk do të ndihmonte për zgjidhjen e pikave të ngritura në Kërkesë/Kundërpërgjigje dhe nuk do të avanconte procesin. Për këtë arsye, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e rrëzon Kërkesën.

15. Si fundi, është e qartë nga materiali para Gjykatësës së Procedurës Paraprake se mbrojtësi Ris nuk kundërshton, si të tillë, caktimin me kusht dhe shumën konkrete të honorarit për ndihmë juridike të përkohshëm, siç përcaktohet në Vendimin e 24 Qershorit 2024.³⁰ Duke mbajtur parasysh se sjellja e tij ndikon drejtpërsëdrejti në të drejtat e klientit të tij, Gjykatësja e Procedurës Paraprake inkurajon Mbrojtësin Ris të ndërmarrë menjëherë hapat e nevojshëm për të përfunduar procesin e nënshkrimit të kontratës. Urdhërohet Zyra Administrative të përfshijë zhvillimet më të fundit në raportin e ardhshëm për Gjykatësen e Procedurës Paraprake.

²⁸ Kundërpërgjigjja, para. 39(g).

²⁹ *Shih* Shtojcën 2 të Parashtrimeve, pika 29, p. 125 (posta elektronike e datës 5 qershor 2024), f. 128, (posta elektronike e datës 31 maj 2024); Pika 31, f. 135 (posta elektronike e datës 20 qershor 2024).

³⁰ *Shih* Shtojcën 2 të Parashtrimeve, pika 37, f. 173 (paragrafi 54). Sidoqoftë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake e kupton se Mbrojtësi Ris nuk pajtohet me vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për t'i akorduar vetëm 1.000 euro në muaj.

V. VENDIM

16. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake

RRËZON Kërkesën.

 /nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E mërkurë, 17 korrik 2024

Në Hagë, Holandë